



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhornî Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.563/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri Kryesues, Ferki Xhaferi dhe Burim Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Ukë Qestaj me vendbanim në Zvicër, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 01.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.563/2021 i paraqitur nga Ukë Qestaj me vendbanim në Zvicër, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën **31.08.2021** PZAP-i, ka pranuar një apel nga Ukë Qestaj me vendbanim në Zvicër, në të cilën pretendohet se KQZ ka bërë shkelje duke e eliminuar mua dhe familjen me arsye kemi dërguar aplikacionet nga emaili i njëjtë. Ne në pamundësi që të aplikojmë personalisht, prindi dhe unë kemi autorizuar familjarin përkatësisht axhin tim që të aplikojë për tërë familjen nga emaili isuf_qestaj@outlook.com, andaj edhe i është refuzuar aplikimi.

Parashtruesi e apelit ka bashkangjitur dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

Me datë 31.08.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur me apelin e parashtruar nga pala ankuese, KQZ brenda afatit kohor është përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se lidhur me këtë apel të parashtruar nga Ukë Qestaj, kanë pranuar në e-mail adresa elektronike "isuf_qestaj@outlook.com" gjithsejtë 14 aplikacione për regjistrim (për 14 persona) edhe pse me mbiemër të njëjtë, këto aplikacione i përkasin aplikuesve që për vendbanim kanë tri shtete të ndryshme, si: Zvicër (përfshirë 9 ankuesit) Gjermani dhe Suedi.

Të gjithë personat me mbiemrin Qestaj (mbiemër i njëjtë) nuk cilësohen si rreth i ngushtë familjarë, për shkak se duke përfshirë edhe ankuesit dhe personat tjerë që kanë vendbanim në Gjemrani dhe Suedi, aplikacionet të të cilëve janë dërguar nga po e njëjta e-mail adresë "isuf_qestaj@outlook.com" nuk janë cilësuar si rreth i ngushtë familjarë, për arsye të se për vendbanim kanë shtete të ndryshme dhe për këtë arsye janë refuzuar që të gjithë.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelimit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit Ukë Qestaj gjatë periudhës për aplikim për regjistrim për votim jashtë Kosovës ka bërë aplikim për regjistrim përmes axhës së tij Isuf Qestaj dhe i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi me të cilin e vërteton faktin se axha i tij Isuf Qestaj ka pasur autorizim siç pretendon në apelin e tij për të aplikuar në emër të apeluesit. Paneli gjithashtu ka konstatuar se edhe pse aplikimi është bërë për persona me mbiemër të njëjtë dhe që kanë vendbanim të njëjtë kjo nuk e vërteton faktin se të njëjtit janë rreth i ngushtë familjar pasi që në rastin konkret nuk është ofruar asnjë provë që dëshmon se të njëjtit janë në lidhje të ngushtë familjare andaj edhe emri i tij nuk figuron në bazën e të dhënave të KQZ-së për votuesit jashtë Kosovës, meqenëse nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: **“çdo person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës”**, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: **“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil”** dhe dispozita e nenit 3.3 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se:

3.3 Personi i cili ka për qëllim të hedhë votën për Votim Jashtë Kosovës...do të regjistrohet në KQZ si votues jashtë Kosovës duke dorëzuar:

a) formularin për Aplikim/Regjistrim për votim jashtë Kosovës, kopja e së cilës është bashkangjitur si Shtojcë II, dhe,

b) dëshminë e dokumentacionit të identitetit dhe që ai ose ajo i plotëson kriteret ligjore për të drejtën për të votuar në pajtim me nenin e LZP-së dhe të bashkangjiten dokumentet e fotokopjuara siç janë të renditura në Shtojcën III. të kësaj rregulle,

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura si më lartë, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret ankuesi thënie e tij nuk i mbështetën në asnjë provë konkrete por se të njëjtat janë supozime dhe se këto pretendime ankuesi nuk i argumenton me asnjë provë.

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se apeli i parashtruar nga Ukë Qestaj nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje e pretenduar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.563/2021 më datën 01.09.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.